REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER BLERINA I. MUSTAFARAJ
ADRESA Bulevardi"Shqipëria",Pallati Agimi,Hyrja 17, Ap. 308
TEL: 694036964

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

**Nr. repertori: 104** **Nr. koleksioni: 56**

**Tirane më 03/03/2022**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

A2022051080002977929

A202205108000297929

# KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

*( TË SHOQËRISË "OZONE" SH.P.K)*

Sot, para meje Notere BLERINA I. MUSTAFARAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Bulevardi"Shqipëria",Pallati Agimi,Hyrja 17, Ap. 308, u paraqit personalisht:

**SHITES**:

Bernard Ndoj, atësia Nikollë, amësia Drane, shtetas Shqiptar, lindur në Kimez, Pukë dhe banues në TIRANË, me adresë Maliq Muço; Nd. 11; H. 2; Ap. 1; Njësia Administrative Nr. 9; Njësia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 25/06/1976, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033481412 dhe nr. personal H60625119L, .

**DHËNËSE PËLQIMI**:

Ana Ndoj, atësia Taulant, amësia Elsa, shtetase Shqiptare, lindur në Elbasan dhe banuese në TIRANË, me adresë Maliq Muço; Nd. 11; H. 2; Ap. 1; Njësia Administrative Nr. 9; Njësia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 26/10/1984, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033946818 dhe nr. personal I46026059I, .

*(Pala shitëse janë bashkëshortë. Pasuria e luajtshme është përfituar përgjatë martesës dhe i përket regjimit pasuror martesor në bashkësi ligjore. Si rrjedhim, pala shitëse janë edhe bashkëpronarë në pjesë të pandarë të pasurisë së sipërcituar;; këtu e më poshtë, për efekte të kësaj kontrate referuar si Shitës).*

**BLERES** :

Ergis Gjonaj, atësia Kastriot, amësia Marie, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Mine Peza; Nd. 256/22; H. 2; Ap. 22; Njësia Administrative Nr. 9; Njesia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 22/05/1983, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033680647 dhe nr. personal I30522160A, .

A2022051080002977929

*(Pala blerëse referuar çertifikatës familjare aksesuar online nëpërmjet sistemit e-Albania, sot në ditën e nënshkrimit të kësaj Kontrate rezulton me gjendje civile "i martuar" . Në këtë kontratë ai do të jetë nën cilësinë e palës blerëse por për shkak të fitimit të pronësisë përgjatë martesës, sipas "Regjimit Pasuror Martesor në Bashkësi", duke qenë se ata nuk kanë lidhur kontratë për regjim tjetër pasuror martesor referuar nenit 77 K. Familjes kjo pasuri e luajtshme do të jetë në bashkëpronesi të të dy bashkëshortëve Ergis Gjonaj dhe bashkëshortes jo-prezente Erisela Dino, atësia Koço, amësia Ermioni, shtetase Shqiptare, lindur në Korçë dhe banues në Tiranë, me adresë Mine Peza; Nd. 256/22; H. 2; Ap. 22; Njësia Administrative Nr. 9; Njesia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 26/06/1985, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 034281473 dhe nr. personal I55626083K (këtu e më poshtë, për efektet e kësaj kontrate referuar si* ***Blerësi****).*

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "OZONE" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

**BAZA LIGJORE**

3.1 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;

3.2 Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";

3.3 Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

**Kushte të përgjithshme**

**A.** Shoqëria "OZONE" SHPK, shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, është regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 29/05/2018, e pajisur me Certifikatë Regjistrimi NUIS (NIPT) L88001503C; me zyrë qendrore në Tirane, Kashar, Rruga Teodor Keko, Pallati G.B-a Dyqani kati 1; me kapital të

A202205108000297929

regjistruar 30.000.000. lekë (tridhjete million lekë) ; me nje ortak, Z. Bernard Ndoj, zotërues i 1 (një) kuote, e cila përbën 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë;

**B.** Pala shitëse është e interesuar të shesë pjesën e kuotës e cila përfaqëson 20 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "OZONE" SHPK dhe pala blerëse është e interesuar të blejë këtë pjesë të kuotës;

**NENI 1**

**Objekti**

1.1 Nëpërmjet kësaj kontrate pala shitëse i shet palës blerëse Ergis Gjonaj, pjesën e kuotës që ajo zotëron në shoqërinë "OZONE" SHPK dhe e cila përbën 20 % të kapitalit të kësaj shoqërie.

1.2 Pas regjistrimit të kësaj kontrate, ortakët e shoqërisë "OZONE" SHPK, do të jenë:

- Bernard Ndoj do të jetë zotërues i një kuote e cila përfaqëson 80 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "OZONE" SHPK;
- Ergis Gjonaj, i cili do të jetë zotërues i një kuote e cila përfaqëson 20 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "OZONE" SHPK.

**Neni 2**

**Çmimi i shitjes dhe mënyra e pagesës**

**2.1.** Kuota do të shitet kundrejt vlerës totale 6.000.000 lekë (gjashte milion lekë. )

**2.2** Vlera e mësipërme do t'i likujdohet Shitësit nga Blerësi në rrugë bankare duke u transferuar në llogarinë bankare të Bernard Ndoj pranë Bankës " Intesa San Paolo Bank" me numër llogarie në lekë 66875435101 dhe me IBAN AL33208110080000066875435101.Mandati bankar bashkëngjitur kësaj Kontrate

**Neni 3**

**Kalimi i pronësisë mbi kuotat**

A202205108000297929

3.1. Blerësi do të bëhet zotërues me të drejta të plota i 1 (një) kuote e cila përfaqëson 20 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "OZONE" SHPK, menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate nga të dyja palët dhe Shitësi heq dorë përfundimisht nga çdo pretendim, të drejta apo detyrime lidhur me këte kuote.

**Neni 4**

**Garancitë**

4.1 Shitësi është pronari i vetëm i ligjshëm i 1 (një) kuote qe perfaqeson 100% të kapitalit te shoqërisë "OZONE" Sh.p.k.

4.2 Shitësi garanton Blerësin që kuota e transferuara eshte krejtësisht e lire nga çdo peng dhe barrë.

**Neni 5**

**Regjistrimi**

5.1 Shitësi dhe Blerësi pranojnë t'i japin njëri tjetrit me kërkesë të palës tjetër dhe/ose Shoqërisë çdo dokument të nevojshëm për të transferuar pjesët e kapitalit që janë objekt i kësaj kontratë dhe për ta regjistruar këtë transferim në Qendrën Kombëtare te Biznesit ne baze te nenit 74 pika 2 te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 « Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare » dhe nenit 43 pika 4 të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

**Neni 6**

**Ligji i zbatueshëm**

6.1 Kjo kontratë rregullohet nga ligji nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës se Shqipërisë", ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe çdo interpretim në lidhje me sa është shprehur më sipër, apo cdo paqartësi përsa i përket interpretimit do të bëhet në përputhje të plotë me këto ligje.

**6.2** Për çdo gjë që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë kontratë, gjejnë zbatim dispozitat ligjore të parashikuara në pikën 6.1, të kësaj dispozite.

**Neni 7**

**Juridiksioni**

**7.1** Në rast të mosmarrëveshjeve që nuk zgjidhen me mirëkuptim mes Palëve, juridiksioni kompetent do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës.

**Neni 8**

**DHËNËSJA E PËLQIMIT**

- Dhënësja e pëlqimit Ana Ndoj është bashkëshorte e ortakut Bernard Ndoj dhe bashkëpronare në kuotën që Bernard Ndoj zotëron në shoqërinë "OZONE" SHPK. për efekt të martesës, deklaron se është dakord që pjesa e kuotës, objekt i kësaj kësaj kontrate, në pronësi të bashkëshortit të tij, t'i shitet Bleresit sipas kushteve te mesiperme.
- Dhënësja e pëlqimit, deklaron se nuk ka asnjë pretendim lidhur me këtë vendimmarrje të bashkëshortit të saj për shitjen e pjesës së kuotës dhe nuk do ketë asnjë pretendim në të ardhmen lidhur me kete shitje.

Neni 9

**ANEKSET E KONTRATËS**

9.1 Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Anekse të Kontratës;

- Vendimi i Asamblesë së Ortakut të Vetëm datë 03.03.2022
- Ekstrakt i Regjistrit Tregtar për Shoqërinë "OZONE" Sh.p.k.. datë 03.03.2022 ;
- Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, Tiranë;
- Faturë e transfertës bankare të Intesa San Paolo Bank sh.a.;
- Çertifikatë familjare e palës Shitëse dhe palës Blerëse;

- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

NENI 10

**DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

10.1 Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

10.2 Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

10.3 Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**PALËT KONTRAKTUESE**

**SHITES**

Bernard Ndoj

**DHËNËSE PËLQIMI**

Ana Ndoj

**BLERES**

Ergis Gjonaj

**NOTER**

BLERINA I. MUSTAFARAJ

Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

## REZULTATET E KËRKIMIT

| | |
|---|---|
| Numri i Rezultatit te Kerkimit: | D-202203039438392 |
| Data e Rezultatit te Kerkimit: | 03.03.2022 |
| Ora e Rezultatit te Kerkimit: | 9:43:08AM |
| Lloji i Kerkimit: | |
| Numri i Dokumentit: | D-400-515-61 |
| Referenca e Perdoruesit: | |

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0**

OZONE SH.P.K.

REGJISTRI I BARREVE SIGURUESE R.B.S. TIRANE - ALBANIA

REPUBLIKA ... BLERINA ...

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

# EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | |
|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | L88001503C |
| 2. Data e Regjistrimit | 01/06/2018 |
| 3. Emri i Subjektit | OZONE |
| 4. Forma ligjore | SHPK |
| 5. Data e themelimit | 29/05/2018 |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 29/05/2018 |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Tirane Kashar KASHAR Rruga Teodor Keko, Pallati G.B-a Dyqani kati 1 |
| 8. Kapitali | 30.000.000,00 |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 1,00 |
| 9. Objekti i aktivitetit | Import - Eksport, shitje me shumice dhe me pakice, grumbullim te lendeve te para te produkteve industriale te ndryshme, leter, hekur, etj. si dhe perpunimin e tyre; prodhim, tregtim te mallrave apo materialeve te ndryshme, importimin dhe eksportimin e lendeve te para apo produkteve gjysem te gatshme. Blerje, shitje, shkembim, Bar - Kafe - Restorant. Import - Eksport, tregtim me shumice dhe me pakice, tregtim te materialeve industriale, produkteve industriale te ndryshme, ushqimore, te gatshme, drithera, fruta perime apo pije te ndryshme. Import - Eksport i lendeve drusore dhe i materialeve te tjera te ndertimit. Hapja e restoranteve, bareve, turizem, import eksport i ambalazheve, i veshmbathjeve dhe i prodhimeve te tjera industriale. Blerje, shitje, shkembime, ndertime objektesh te ndryshme, meremetime, riparime, rikonstruksione. Furnizimin, instalimin, tregtimin, mirembajtjen dhe drejtimin e impianteve te çfaredo lloji, pajisjeve telefonike, informatike, elektronike, te ngrohjes, te kondicionereve si dhe sherbime te tjera te ndryshme telefonike, etj. Per realizimin e objektit dhe |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

| | | |
|---|---|---|
| | te qellimeve te saj shoqeria mund te zhvilloje çdo lloj aktiviteti industrial, tregtar, prodhimi apo keshillimi te konsideruara te dobishme dhe te nevojshme per qellimet e shoqerise dhe qe nuk eshte i ndaluar me ligj. | |
| 10. Administratori/ët | Ergis Gjonaj | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 02/12/2019 | Deri: 02/12/2024 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 12. Ortakët | BernardNdoj | |
| 12.1 Vlera e kapitalit | Para: 30.000.000,00 | Natyre: |
| 12.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 100,00 | |
| *Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)* | | |
| 12.4 Komente (nëse ka) | | |
| 13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | Lezhe Lezhe LEZHE Shetitorja Gjergj Fishta, Ish- MAPO dy kateshe, Zona Kadastrale 8632, Nr Pasurie 6/284-N6 dhe 6/284-N7, Siperfaqe 163 m2<br>Tirane Tirane TIRANE Rruga Mihal Grameno, Nr 44/2, Siperfaqe 62m2, Kodi vendor 08326, Ndertese 1-kateshe<br>Tirane Tirane TIRANE Rruga "Mihal Grameno", Zk. 8150, nr. pasurie 7/690- N3 & 7/690-N1, 137 m2, kati 1 & 137 m2, kati 2 komunikuese. Totali 274 m2. | |
| 14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: OZONE; OZONE ELECTRONICS<br>E-Mail: e.gjonaj@ozone.com.al<br>Telefon: 0672071681 | |
| 15. Statusi: | Aktiv | |

Datë: 03/03/2022

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date:2022/03/03 09:36:44 +01:00
L88001503C2022030309363319
2006



*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)*

VENDIM I ORTAKUT TË VETËM
TË SHOQËRISË"**OZONE " shpk**
Datë 03.03.2022

Sot, në datë 03.03.2022, **SHOQËRIA "OZONE sh.p.k"**, shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, është regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 29/05/2018, e pajisur me Certifikatë Regjistrimi NUIS (NIPT) L88001503C; me zyrë qendrore në Tirane, Kashar, Rruga Teodor Keko, Pallati G.B-a Dyqani kati 1; me kapital të regjistruar 30.000.000. (Tridhjete miljon) lekë; me nje ortak të vetëm Bernard Ndoj, zotërues i 1 (një) kuote, e cila përbën 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë vendosi:

I pranishem ne mbledhje ishte :
**Bernard Ndoj,** ortak i vetëm i Shoqerisë, zotërues i 1 (një) kuote, e cila përbën 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë;

VENDOSI

1. Shitjen e një kuote cila përbën 20 % të kapitalit të kësaj shoqërie kundrejt vlerës totale 6.000.000 (Gjashte milion leke) lekë.
2. Depozitimin e këtij Vendimi, së bashku me Kontratën e Shitjes së Kuotave pranë QKB nga personi i autorizuar.

Vendimi u mor nga ortaku i vetëm Z. Bernard Ndoj.

ORATAKU I VETËM
BERNARD NDOJ

OZONE Sh.p.k
NUIS : L 88001503 C